VENDIM
Nr.113, datë 20.1.1997

PËR NORMAT E STREHIMIT NË BANESAT E NDËRTUARA ME FONDE SHTETËRORE

Me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike, Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Normë strehimi në banesat e ndërtuara me fonde shtetërore sipas këtij vendimi, do të kuptohet sipërfaqja e banimit në metër katror që i takon një personi.

Sipërfaqja e banimit brenda një apartamenti tip i referohet sipërfaqes totale të dhomave të gjumit dhe dhomës së ditës, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.567, datë 6.12.1993 "Për normat e projektimit të banesave".

2. Norma e strehimit për familjet që trajtohen me banesa të ndërtuara me fonde shtetërore është 9—11 m^2/person (metër katror për person).

Çdo sipërfaqe e tepërt mbi këtë normë, si dhe çdo sipërfaqe e tepërt ndërtimi mbi normat e projektimit sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.567, datë 6.12.1993, përballohet me pagesë të menjëhershme nga vetë qytetarët.

4. Urdhëresa e Këshillit të Ministrave nr.1, datë 7.7.1989 "Për administrimin e kërkesave për banesa dhe shpërndarjen e tyre", si dhe çdo akt nënligjor që bie në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi